


ACDC
Advocacy Center For Democratic Culture

NDIKIMI I VIRUSIT COVID-19 NË BESIMIN E QYTETARËVE




ANALIZA E HULUMTIMIT

Prill, 2020

Përmbajtja

Konteksti i hulumtimit.....	4
Metodologjia e hulumtimit.....	5
Rezultatet më të rëndësishme	6
Përmbledhja e hulumtimit - Perceptimi i çështjeve kryesore.....	7
Demografia.....	8
Rezultatet e hulumtimit.....	10
Konkluzionet	21



Konteksti I hulumtimit

Koronavirusi i ri, Covid-19, është një sfidë globale e cila kërkon përgjegjësi individuale të veprimit. Secili qytetar, individualisht, si dhe bizneset, institucionet dhe organizatat, mund të ndërmarrin veprime për t'u mbrojtur më mirë nga virusi dhe të jenë të përgatitur për situata të paparashikueshme. Parashikimet dhe vlerësimet janë tashmë të disponueshme që Covid-19 do të shkaktojë një tronditje të madhe në ekonominë e shumë vendeve, por edhe për ekonominë globale.

Vendet e rajonit kanë reaguar në mënyrë të ndryshme në shfaqjen e koronavirusit. Mediat e Prishtinës raportojnë se rastet e para të të infektuarve me korona virus janë regjistruar në 13 Mars 2020, ndërsa Qeveria e Kosovës, më 11 mars, pas mostrave të para të testuara, tashmë ka miratuar një seri masash për të parandaluar përhapjen e epidemisë. Masat e para kufizuese përfshinin shkollat, kopshtet dhe fakultetet. Përveç mbylljes së shkollave, linjat ajrore dhe ato rrugore u ndërpre në vendet me rrezik të lartë ose të mesëm nga korona virusi. Masat parandaluese gjithashtu përfshijnë ndalimin e funksionimit të restoranteve, klubeve të natës dhe palestrave. Popullsia globale gjithashtu përballet me ndikim psikologjik, me moral të ulët dhe ankth të shtuar për shkak të izolimit, pasi kontaktet njerëzore dhe liria e udhëtimit janë pothuajse plotësisht të kufizuara.

Për shkak të situatës së re të shkaktuar nga pandemia COVID-19, ka konflikt mendimesh të ndryshme si dhe të menduarit e ndryshëm midis qytetarëve si për situatën e sigurisë ashtu edhe për besimin që ata kanë ndaj institucioneve të kujdesit shëndetësor dhe zyrtarëve qeveritarë.

Është shumë e rëndësishme të merren informacione për gjendjen e vetëdijes dhe besimit të popullatës, si nga popullata e vetëqeverisjes lokale, ashtu edhe nga këndvështrimi i qytetarëve, në mënyrë që mënyra e organizimit dhe e parametrave dhe masave të sigurisë të mund të përshtaten në mënyrë adekuate me situatën.

Për të gjitha që u thanë më sipër, Qendra për Avokimin e Kulturës Demokratike (ACDC) ka realizuar një hulumtim mbi ndërgjegjësimin dhe mendimin e qytetarëve për situatën dhe besimin e tyre aktual. Sipas situatës aktuale, anketimi është realizuar përmes një studimi në internet të cilën e kanë plotësuar 577 njerëz nga pothuajse të gjitha komunat me shumicë serbe në territorin e Kosovës, dhe mendimet e tyre janë përfshirë në rezultatet dhe analizat e paraqitura.

Me këtë hulumtim morëm një pamje më të përafërt në lidhje me atë se sa janë qytetarët të vetëdijshëm për problemin e situatës së re në çfarë mase dhe në këndë ata kanë besim më të madh.

Metodologjia e hulumtimit

- Hulumtim kuantitativ -

Mënyra e hulumtimit: Internet anketë.

Vendi i hulumtimit: Të gjitha komunat e Republikës së Kosovës

Koha e hulumtimit: 1 prill – 20 prill 2020.

Madhësia e mostrës: 577 të anketuar nëpërmjet sondazheve të internetit.

Përshkrimi i mostrës: Nga 577 të anketuar, 45.5% ishin meshkuj dhe 55.5% ishin femra.

Lloji i mostrës: Mostra e rastësishme përfaqësuese e strukturuar, bazuar në komunën e vendbanimit

Poststratifikimi: Vitet, niveli i arsimimit dhe statusi i punës

Rezultatet më të rëndësishme

91% të anketuarish janë shumë mirë ose pjesërisht të informuar në lidhje me situatën aktuale

72% të anketuarish mendojnë se situata e sigurisë është përmirësuar ose ka mbetë e njëjtë

79% të anketuarish besojnë se qytetarët në mjedisin e tyre respektojnë masat e paraqitura

64% të anketuarish ose nuk e dinë ose mendojnë se nuk ka shërbime të mbështetjes psikosociale në gjuhën e tyre amtare

45.7% qytetarë mendojnë se rrezimi i Qeverisë së Kosovës është i papranueshëm kurse 27.1% nuk janë të sigurt

55.3% të anketuarish mendojnë se bashkësia ndërkombëtare nuk po bën sa duhet për të frenuar përhapjen e virusit

61% të anketuarish besojnë se ndihma e duhur qeveritare do të reflektohej në një lloj subvencionit

Përmbledhja e hulumtimit - Perceptimi i çështjeve kryesore


Rezultatet e sondazhit:

- Informimi: hulumtimi ka treguar që qytetarët janë të informuar mirë për situatën aktuale.
- Shumica e institucioneve të Kosovës gëzojnë besim shumë të ulët të qytetarëve
- Një numër i vogël i të anketuarve do të pajtoheshin të trajtohen në institucionet shëndetësore të Kosovës
- Shumica e të anketuarve informohen përmes internetit dhe mediave nga Beogradi
- Mendimi është se bashkësia ndërkombëtare në Kosovë nuk po bën sa duhet për të parandaluar përhapjen e virusit
- Një numër i madh i të anketuarve besojnë se rrëzimi i Qeverisë së Kosovës është i papranueshëm në këtë situatë.

Demografia


1. Gjinia

562 responses




2. Moshë

564 responses



3. Komuna

531 responses




- Mitrovica e Veriut
- Zvecan
- Zubin Potok
- Leposaviq
- Shterpce
- Graçanica
- Klllokot
- Novo Bërdë

▲ 1/7 ▼

4. Arsimi


556 responses



- Shkolla fillore e pa përfunduar
- Shkolla fillore e përfunduar
- Shkolla e mesme e përfunduar
- Studimet themelore (në vazhdim)
- Studimet themelore (përfunduar)
- Studimet postdiplomike (në vazhdim)
- Studimet postdiplomike (përfunduar)

5. Përkatësia etnike

560 responses




- Shqiptarë/e
- Boshnjakë/e
- Goranë/e
- RAE
- Serb/e
- Turk/e
- Malazezë/e
- Prizren

▲ 1/2 ▼


6. Statusi i punës

563 responses




Rezultatet e hulumtimit

7. Në çfarë mënyre korona virusi, dhe masat të cilat aplikohen, ndikojnë në




Siç mund ta shohim nga grafiku, pothuajse të gjithë të anketuarit pajtohen që ka pasur një përkeqësim në pothuajse të gjitha fushat e lartpërmendura, megjithëse shumica besojnë se situata e sigurisë, mbrojtja sociale dhe besimi në institucione kanë mbetur në të njëjtin nivel. Edhe para pandemisë, qytetarët e Kosovës nuk ishin të kënaqur me këto institucione, dhe tani

kjo pakënaqësi ka dalë në pah, pasi ata janë përballur me një situatë që ka tronditur sistemet shtetërore shumë më të zhvilluara në të gjithë botën.



Ashtu siç edhe pritej në kohën e sotit, 79.6% e të anketuarve janë të informuar për situatën përmes Internetit, megjithëse një përqindje e mirë e tyre, 59% thanë që kanë marrë informacione nga mediat e Beogradit. 44.1% e qytetarëve gjithashtu e gjejnë burimin e informacionit në mediat e Prishtinës, gjë që është rasti sidomos për njerëzit që jetojnë në qendrën e Kosovës. Mbulimi i mediave të Beogradit tejkaloi në mënyrë sasiore mbulimin e mediave lokale nga Kosova, si dhe mbulimin e mediave të Prishtinës. Një numër i madh fjalimesh nga Presidenti i Serbisë, si dhe nga Shtabi i Krizave dhe të gjitha institucionet e përfshira në zgjidhjen e pandemisë, kanë rezultuar në rritjen e përcjelljes së mediave të Beogradit.



Me një përfaqësim kaq të lartë të informacionit për secilin lloj të mediave, për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve, të cilët janë çelësi për të dalë nga kjo situatë, pritet që shumica dërrmuese të jenë shumë mirë, 58.5% ose deri diku të informuar, 32.8%, për procedurat që

lidhen me COVID-19. Sjellja e tyre, d.m.th. respektimi i masave është thelbësor në këto situata, kështu që të gjitha mediat kanë bërë përpjekjet që këto informata të arrijnë tek qytetarët.




Është interesante që 37.3% e të anketuarve besojnë se situata e sigurisë është përmirësuar me futjen e masave për të parandaluar përhapjen e virusit COVID-19, kurse 34.6% besojnë se nuk ka pasur ndryshime të mëdha. 17% ndjehen më pak të sigurt.



Një total prej 45.8% e të anketuarve thanë që nuk kishte ndryshime të rëndësishme në besimin ndaj SHPK-së. Sidoqoftë, 22.8% besojnë se besimi është rritur që nga fillimi i pandemisë, edhe pse policia e Kosovës nuk ka pasur mundësi dhe nevojë të tregojë gatishmërinë e tyre të plotë për të vepruar në këto kohë, duke pasur parasysh numrin e vogël të qytetarëve të prekur dhe respektimin e masave të sjella nga Qeveria e Kosovës. Prania e tyre është parë në një masë shumë më të madhe se më parë. Është rritur numri i policëve në terren, gjë që vendos më shumë besim në punën e tyre.

12. A ju ka njoftuar qeveria lokale në mënyrë adekuate për situatën dhe ndryshimet në lidhje me masat që janë marrë?


562 responses



Pastaj, 48.8% e të anketuarve mendojnë se qeverisja lokale ka përcjellë informacione të duhura në lidhje me masat që po zbatohen (me qëllim të luftimit të virusit Covid 19). Mirëpo, 34.7% e të anketuarve besojnë se nuk është ashtu rasti, pasi, kur merren parasysh edhe 16.5% e atyre që nuk janë të sigurt, tregon se shumica mendojnë se vetëqeverisja lokale mund të kishte bërë më shumë për të informuar popullatën.

13 A keni pasur mundësi si qytetarë/e që të njiheni në gjuhën tuaj amtare për masat e ndërmarra nga Qeveria lokale dhe qendrore?

562 responses




Shumica e të anketuarve mendojnë se mbi masat e autoriteteve qendrore dhe lokale mund të informoheshin në gjuhën e tyre. 24.4% thanë se nuk e kishin këtë mundësi.



Është mirë që rreth 79% e të anketuarve deklaruan se njerëzit nga mjedisi i tyre respektojnë masat e mara, që do të thotë se vetëdijësimi i qytetarëve për pasojat e Covid 19 është i lartë. Nga ana tjetër, 21% besojnë se njerëzit nuk respektojnë plotësisht këto masa.




52.7% pjesërisht i përmbahen masave të vendosura, kurse 36.5% plotësisht i përmbahen.



Arsyeja më e madhe për mosrespektim të masave është një kuptim joserioz i situatës dhe papërgjegjësia.




Sa i përket shërbimeve të mbështetjes, 43.5% e të anketuarve nuk e dinë nëse ka mbështetje psikosociale në gjuhën e tyre amtare, ndërsa 34.6% mendojnë se një mbështetje e tillë ekziston dhe 20.9% nuk mendojnë se ekziston. Një përqindje shqetësuese e madhe e të anketuarve ose nuk e dinë ose mendojnë se shërbime të mbështetjes psikosociale nuk ekzistojnë, megjithëse një mbështetje e tillë është shumë domethënëse gjatë periudhave të izolimit për shkak të epidemisë. Sipas rezultateve të marra, është e qartë se ka mungesë informacioni në lidhje me këtë ndihmë dhe mbështetje për qytetarët, gjë që është shumë e rëndësishme duke pasur parasysh që numri i dhunës në familje, si dhe numri i problemeve psikologjike të shkaktuara nga izolimi dhe frika u rrit ndjeshëm.



Siç pritej, shumica e njerëzve marrin ato masa që janë në dispozicion të tyre dhe të përcaktuara nga Qeveria dhe Organizata Botërore e Shëndetit. Shumica e të anketuarve kanë zgjedhur përdorimin e maskave mbrojtëse dhe dorezave (73.6%), dezinfektimin e hapësirës së jetesës (61.8%) dhe izolimin e pjesërishëm (58%), të cilat edhe janë masat më të rekomanduara.

17. Në rast se infektoheni, a do të ishit të gatshëm që për ju të kujdesen institucionet e kujdesit shëndetësor të Kosovës?

559 responses




- Po, mendoj se do të sillëshin mirë ndaj meje
- Po por nuk do të ndihesha mirë
- Vetëm në rast që nuk kam opion tjetër
- Në asnjë rast nuk do pajtohesha vullnetarisht për këte
- Refuzoj të përgjigjem

Një total 36.9% e të anketuarve do të pajtoheshin me këtë vetëm nëse nuk ka mundësi tjetër. 28.4% në asnjë mënyrë nuk do të pajtoheshin vullnetarisht për një gjë të tillë, 17.4% mendojnë se do të ishte në rregull dhe 10.2% do të pajtoheshin, por nuk do të ndjeheshin mirë për këtë. Fatkeqësisht, të gjitha dobësitë e sistemit shëndetësor në Kosovë janë shfaqur, ekziston një besim i pamjaftueshëm i qytetarëve, si dhe mungesë e pajisjeve dhe stafit. Të vetëdijshëm për këtë, qytetarët kanë shumë frikë se nëse infektohen nuk do të kujdesen siç duhet në institucionet e Kosovës.

18. A është furnizimi me material mjekësor në vendin tuaj i njëjtë me shumicën shqiptare?

557 responses




- Po, mendoj që furnizimi është edhe më i mirë
- Furnizimi është i njëjtë
- Jo, mendoj që furnizimi është më i keq
- Refuzoj të përgjigjem

Përqindjet në këtë pyetje janë shpërndarë pothuajse në mënyrë të barabartë në tre përgjigjet. Përkatësisht, 27.3% e të anketuarve besojnë se masat ishin rregulluar dhe është marrë parasysh pozicioni i komunitetit, 26.5% mendojnë se pozicioni specifik i komunitetit nuk është marrë parasysh, ndërsa 21.6% e qytetarëve besojnë se ka pasur disa lëshime.

19. A mendoni se gjatë aplikimit të masave është marrë parasysh pozicioni specifik i komunitetit tuaj?


550 responses




- Po, mendoj se masat janë përshtatur
- Po, edhe pse ka pasur ca lëshime
- Jo, edhe pse situata është asisoi që kjo arsyetohet
- Nuk është marrë parasysh pozita specifike e komunitetit tim
- Refuzoj të përgjigjem

Për këtë pyetje, përqindjet janë shpërndarë në mënyrë të barabartë në tre përgjigje. Masat janë përshtatur, 27.3%, nuk u mor parasysh pozicioni specifik i komunitetit tim, 26.5%, po megjithëse kishte disa lëshime, 21.6%.


20. Vlerësoni shkallën e besimit që keni gjatë kësaj situatë krize ndaj:



20. Vlerësoni shkallën e besimit që keni gjatë kësaj situatë krize ndaj:



Në varësi të opsioneve të kontrolluara, përgjigjet shkojnë nga besimi i ulët për institucionet e Kosovës, autoritetet lokale, policinë e Kosovës, mediat e Prishtinës, median lokale dhe Komunitetin Ndërkombëtar, deri te besimi i lartë në institucionet e Republikës së Serbisë, sistemi shëndetësor i Serbisë dhe mediat në Beograd.



Është për t'u lavdëruar që rreth 63% e të anketuarve mendojnë se Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë masa të përshtatshme ose pjesërisht të përshtatshme për të luftuar përhapjen e virusit. Edhe pse u përball me shumë probleme, ajo ishte në gjendje të ndërmerre masa në kohën e duhur dhe t'i modifikonte ato për të përmbushur nevojat e banorëve dhe për të parandaluar përhapjen e pandemisë.



Pothuajse 46% e të anketuarve mendojnë se rrëzimi i Qeverisë së Kosovës për momentin është i papranueshëm, 27% nuk mund të vendosin dhe vetëm rreth 13% mendojnë se ka justifikim për këtë. Pakënaqësia ndaj veprimeve të tilla nga qeveria e Kosovës është e pritshme, pasi në këto momente pritet që ajo të luftojë për mbrojtjen e qytetarëve të saj dhe shëndetin e tyre.

23. Çfarë flet kjo për Qeverinë e Kosovës dhe cili është mendimi juaj për situatën aktuale politike në Kosovë? Ju lutemi jepni përgjigjen tuaj

406 responses

Nuk kam mendim

Joserioziteti

Nuk kamë koment

Katastrofë

Nuk e di

Tmerr

Refuzoj të përgjigjem

Haotike

23. Çfarë flet kjo për Qeverinë e Kosovës dhe cili është mendimi juaj për situatën aktuale politike në Kosovë? Ju lutemi jepni përgjigjen tuaj

406 responses

Interesat individuale qiten para intereseve të popullit

Ata nuk e bëjnë punën e tyre

Flet për jostabilitetin e sistemit dhe ndikimin të fortë të jashtëm

Asgjë nuk dihet

Vetëm pozita e tyre ka rëndësi


Nuk dijnë të bëjnë punën e tyre

Kurrfar Qeverie

E keqe në përgjithësi, si gjithmonë ashtu do të mbetet, do të ndërrohen non stop. Një vend i fortë dhe një vend i vërtetë është SERBIA!

Qeveria më e mirë në regjion në 20 vitet e fundit

Përgjigjet për këtë pyetje thjesht tregojnë se mendimi i të anketuarve është kryesisht kritik për Qeverinë e Kosovës dhe situatën politike. Pakënaqësia rrjedh qartë nga shumë probleme me të cilat përballen qytetarët, si dhe nga informacionet e vazhdueshme kontradiktore që marrin qytetarët nga mediat.



Ky mendim kritik përfshihet edhe në përgjigjet e kësaj pyetje. Vetëm 14.6% e të anketuarve mendojnë se bashkësia ndërkombëtare në Kosovë po bën mjaftueshëm për të luftuar virusin COVID-19, ndërsa 55.3% kanë mendim krejt të kundërt dhe 30% refuzojnë të komentojnë. Fatkeqësisht, ka pak informacion mbi punën e organizatave ndërkombëtare në dispozicion të qytetarëve dhe mungesa e informacionit jep përshtypjen se ndihma nuk ekziston.



Ndryshimet në përgjigjet e kësaj pyetje janë aq të mëdha sa nuk mund të thuhet me siguri se cila nga organizatat ka bërë diçka. Me 6.8% mund të veçohet vetëm UNHCR.

24b. Nëse përgjigja është JO, çfarë duhet të bëjnë organizatat ndërkombëtare për të luftuar përhapjen e infeksionit të virusit korona?


244 responses

- Le të mos bëjnë asgjë më mirë do të kalojmë
- Më shumë aktivitete në teren, më shumë ndihmë materiale
- Më shumë testime, reagim i shpejtë, dhe dije për këtë virus
- Ta tregojnë numrin e vërtetë të të infektuarve
- Shumë çka
- Shumë gjëra të mos i numërojë
- Bashkësia ndërkombëtare në vend që të merret me gjendjen shëndetësore, ekonomike dhe sociale angazhohet në grindjet e politikanëve dhe partive politike, grindje
- Më shumë mjete medicinale, angazhim i shtuar i profesionistëve medicinal
- Të sillen profesionistë për shërimin e virusit Corona

Të anketuarit kanë renditur një numër opsionesh dhe përgjigjesh këtu, ndërsa ato më shpesh të përmendurat janë këtu.

25. Në çfarë mënyre shteti mundet me ju ndihmu qytetarëve pas përfundimit të pandemisë?

511 responses



- Subvencione për gr. marginalizuara
- Subvencione per ndërmarrjet e vogla
- Miratimi kredive pa kamatë
- Punësimi i të rinjëve që dëshirojnë.
- Ndihmë në të holla kuptohet
- Vetëm juve të mos ju japin sepse....
- Ndihmë financiare për qytetarët
- Grante

▲ 1/8 ▼

Një nga zgjidhjet që Qeveria mund të zbatojë është subvencionet për ndërmarrjet e vogla prodhuese dhe bujqësore, me 36.6%. Kreditë pa interes me një periudhë mospagimi më të gjatë për promovimin e fermerëve janë e dyta me 27.6%, ndërsa subvencionet për grupet e marginalizuara janë e treta me 24.5%.

26. Komete shtesë, nëse keni

132 responses

Nuk kamë

Vetëm së bashku do ta mundim coronën

Shpresoj që kam kontribuar, këtu jamë nëse ka nevojë për qfarëdo ndihme 🙏

Panikë mbizotëron mes njerëzve kurse coronë nuk ka

Momentalisht situata financiare është shumë e rëndë, çdo gjë është ndalur

.....

Zoti sheh krejt, secilit ashtu si e meriton

//////

Të mos dalim jashtë, do të jetë më mirë për të gjithë

Ndoshta komenti më i mirë shtesë mund të jetë përgjigja se "Vetëm me forca të përbashkëta mund ta mundim koronën"

Konkluzione:

Situata të vështira dhe periudha të vështira te njerëzit zgjojnë dëshirën për të ndihmuar dhe përpjekjet për t'u bashkuar. Kjo është e mjaftueshme në disa situata, por në një pandemi të kësaj madhësie, kur e gjithë bota është një vatër e nxehtë, njerëzit me të drejtë kërkojnë ndihmë nga zyrtarët e qeverisë. Situata të tilla ndërtojnë besim por edhe mosbesim. Është shumë e rëndësishme të dini se kujt, kur dhe si të ja dhuroni atë besim. Si dhe kujt t'i besohet jeta në ruajtje. Shumica e qytetarëve besojnë se epidemia e virusit Covid 19 ka çuar në përkeqësim të situatës së përgjithshme, sigurisë, situatës financiare, mbrojtjes sociale, si dhe besimit në institucione. Pak prej tyre besojnë se situata e përgjithshme ka mbetur e njejtë. Kjo është, natyrisht, një fakt shkatërrues për të gjithë sistemin, sepse në këtë situatë Qeveria e Kosovës, qeveritë lokale dhe institucionet e tjera duhet të bashkëpunojnë për të luftuar pandeminë.

Serbët e Kosovës në këtë situatë ishin gjithashtu në gjendje të ndiejnë ndarjen dhe dualizmin e sistemit të dyfishtë në këtë situatë, pasi konfuzioni për respektimin e masave bëri që disa prej tyre të ndryshonin nga dita në ditë në fillim të pandemisë, ndërsa në të njëjtën kohë u aplikuan masa zbatuese nga të dyja anët.

Qëllimi i këtij studimi ishte të vlerësohet niveli i besimit që qytetarët kanë dhe kujt i besojnë më shumë. Informacioni i të cilit është më afër gjendjes aktuale në teren. Kush ofron kujdes më të duhur shëndetësor dhe cili është furnizimi me pajisje mjekësore dhe barna.

Rezultatet e sondazhit tregojnë se qytetarët, të paktën ata që e plotësuan anketën, kanë besim më të madh në institucionet shëndetësore të Republikës së Serbisë, ndërsa një përqindje më e vogël e atyre që janë anketuar do të trajtoheshin në institucionet shëndetësore të Kosovës vetëm nëse nuk do të kishin mundësi të tjera.

Një numër i madh i të anketuarve theksuan mediat e Beogradit si qendrën e informacionit, e cila mund t'i atribuohet mungesës së informacionit nga institucionet e Kosovës dhe mediat lokale, raportimi i të cilave për cilësinë dhe përmbajtjen ishte i pamjaftueshëm, ndryshe nga mediat e Beogradit.

Besimi në institucionet e Republikës së Kosovës është vlerësuar i ulët, qoftë ai nga institucionet qendrore apo lokale, policia e Kosovës, sistemi shëndetësor i Kosovës dhe madje edhe bashkësia ndërkombëtare. Edhe në një situatë të forcës madhore, qytetarët nuk kanë treguar besim të mjaftueshëm në institucionet e Kosovës, megjithëse të gjitha këto institucione janë të përfshirë në luftimin e pandemisë. Arsyet mund të jenë për shkak të një sistemi të pazhvilluar ose mungesës së pajisjeve, si dhe një gatishmëri të pamjaftueshme për t'iu përgjigjur një pandemie.

Nga ana tjetër, ky besim është i lartë ndaj institucioneve të Republikës së Serbisë, sistemit shëndetësor të Republikës së Serbisë dhe mediave nga Beogradi, të cilat, për të parandaluar përhapjen e epidemisë dhe mbrojtjen e qytetarëve, kanë ndërmarrë një sërë masash, nga futja e gjendjes së jashtëzakonshme, organizimi i spitaleve të përkohshme, deri në furnizim me pajisje mjekësore dhe barna. Sigurisht, të gjitha këto masa u mbuluan nga media, ndërsa qytetarët e nacionalitetit serbë në veçanti nuk kishin informacion të mjaftueshëm për reagimin e institucioneve të Kosovës, përveç masave të paraqitura.

Një problem i madh është edhe informacioni që mbërrin VETËM në gjuhën shqipe, gjë që çon gjithashtu në mosbesim. Të gjitha deklaratat duhet të vihen në dispozicion të mediave në të dy gjuhët, të përkthyer me saktësi, nëse dikush do të punojë në ngritjen e besimit.

Nëse flasim për shërbime të mbështetjes psikosociale, arrijmë në rezultate që tërheq vëmendjen tonë për faktin se qytetarët nuk janë të informuar se ekzistojnë këto shërbime.

Kompetentët duhet të adresojnë këtë temë. Është për t'u lavdëruar që qytetarët janë të vetëdijshëm për situatën dhe që shumica e tyre i përmbahen masave të marra. Pothuajse gjysma e të anketuarve besojnë se pushteti vendor i ka informuar në mënyrë të duhur për situatën aktuale.

Në luftën kundër një problemi të tillë, besimi luan një rol të madh. Është shqetësuese që ky besim në institucionet e Kosovës është në një nivel shumë të ulët dhe duhet të përmirësohet. Mënyra e vetme për ta arritur këtë është përmes bashkëpunimit dhe respektit të vërtetë të ndërsjellë. Nëse nuk është kështu, vështirë se do të ketë besim.

Shumica e qytetarëve ende i drejtohen institucioneve të Republikës së Serbisë për ndihmë. Kjo është logjike duke pasur parasysh që sistemi shëndetësor i Republikës së Serbisë po funksionon në veri, dhe ky fakt sigurisht që është thelbësor për sa i përket besimit të qytetarëve në institucione gjatë epidemisë. Do të ishte ideale, nëse institucionet e të dy sistemeve do të bashkëpunojnë më shumë dhe do të reagojnë dhe do të punojnë së bashku për të zgjidhur problemet. Sidoqoftë, në përfundim duhet të thuhet se ekziston një marrëveshje lidhur me hyrjen në Kosovë të mjekëve nga Beogradi, si dhe barnat dhe pajisjet mjekësore.

Një vëzhgim tjetër interesant është se qytetarët mendojnë se bashkësia ndërkombëtare nuk po bën një punë të shkëlqyeshme në luftën kundër Covid 19. Disa nga përgjigjet e qytetarëve janë se ata duhet të jenë më aktivë në terren dhe në ndihmë materiale, të sigurojnë më shumë pajisje mjekësore dhe profesionistë, të reagojnë më shpejtë, të raportojnë rregullisht numrin e të infektuarve dhe ngjashëm.

Disa nga masat e ndihmës qeveritare që mund të zbatohen pasi të ketë mbaruar epidemia, përfshijnë, subvencione për ndërmarrje të vogla prodhuese dhe bujqësore, dhënie e kredive pa interes me një periudhë mospagimi më të gjatë për fermerët, dhe subvencione për grupet e marginalizuara.